

TLAS




SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË

Gazeta TLAS

Botim i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë

Nr. 2 / 2011

NUMRI TOTAL I ÇESHTJEVE NE VITE
Janar 1999 - Dhjetor 2010



Botimi i këtij materiali është mbështetur
financiarisht nga UNICEF



KENI FËMIJË TË PAREGJISTRUAR?

Si ta regjistroj fëmijën tim në gjëndjen civile?

Regjistrimi i fëmijës në zyrën e gjëndjes civile e bën atë shtetas shqiptar, me të gjitha të drejtat kushtetuese. Kujdesi për fëmijën duhet të fillojë që me shtrimin e nënës në qëndrat shëndetësore. Në rradhë të parë nëna duhet të pajiset me letërnjoftim, në mënyrë që ajo të identifikohet saktësisht në maternitet.

Kush mund ta regjistrojë fëmijën në gjëndjen civile?

- Nëna e fëmijës;
- Babai i fëmijës, nëse ai ka martesë ligjore me nënën;
- Personat madhorë që janë në fletën familjare të nënës së fëmijës.

Për fëmijët e lindur në maternitet:

Nëna! Merrni me vehte në maternitet letërnjoftimin tuaj, ose në mungesë të tij, merrni një çertifikatë familjare nga zyra juaj e gjëndjes civile. Regjistrimi i rregullt i nënës në maternitet, me emrin dhe mbiemrin e saktë, është kushti i parë për regjistrimin e rregullt të fëmijës.

Nëse të dhënat e nënës nuk janë të sakta, regjistrimi i fëmijës mund të kërkojë një proces më





të vështirë. Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) është i gatshëm të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe gjyqësore për regjistrimin e fëmijës tuaj.

Për fëmijët e lindur në kushte shtëpie:

Nëna! Kur fëmija juaj lind jashtë institucioneve shëndetësore, kontaktoni brënda disa ditëve qëndrën më të afërt shëndetësore ose maminë e zonës të caktuar zyrtarisht dhe merrni certifikatën e asistencës në lindje. Kujdes! Jepni emrin dhe mbiem-

rin e saktë, sipas regjistrimit tuaj në gjëndjen civile. Tregoni letërnjoftimin tuaj, ose çdo dokument tjetër shtetëror me fotografi. Nëse ju do të keni certifikatën e asistencës në lindje të firmosur nga mamia dhe të vulosur nga qendra shëndetësore, atëherë fëmija juaj do të regjistrohet njësoj si të gjithë fëmijët e tjerë të lindur në maternitet.

Nëse nuk do të ndiqni këtë rrugë, regjistrimi i fëmijës mund të bëhet vetëm me anë të një procesi të gjatë gjyqësor. Shërbimi Ligjor Fala Tiranë (TLAS) është i gatshëm të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe gjyqësore për regjistrimin e fëmijës tuaj.

Për fëmijët, nënat e të cilëve nuk interesohen për regjistrimin e tyre:

Në këtë grup fëmijësh hyjnë fëmijët që janë lindur nga nëna që nuk kanë martesë me babain e fëmijës dhe që ose nuk dihet se ku janë, ose nuk duan të kryejnë regjistrimin e fëmijës. Në

përgjithësi këta fëmijë rriten në familjen e babait natyror, nga babai, gjyshërit, ose nga familjarë të nënës.

Në rastet kur këta fëmijë kanë lindur jashtë institucioneve shëndetësore, ose në rastet kur ata kanë lindur në maternitet, por familjarët e nënës nuk duan të kryejnë regjistrimin, Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, ka përpunuar një procedurë për regjistrimin e tyre në bashkëpunim me organet e rendit dhe me punonjësit sociale të njësisë vendore duke shfrytëzuar hapësirën që krijohet në ligj në “regjistrimin e personave të gjetur”, duke supozuar që këta fëmijë të konsiderohen si të gjetur, në momentin që dikush raporton për ekzistencën e tyre, në organet e rendit. Në bazë të raportimit në organet e rendit, të personit që pretendon se është babai, gjyshi/gjyshja nga babai ose nëna, xhaxhai/halla e fëmijës, atje mbahet një proces verbal që nënshkruhet nga shtetasi raportues, përfaqësuesi i organeve të rendit, si dhe punonjësi social i njësisë

vendore. Ky proces verbal do të jetë baza për regjistrimin e fëmijës në bazë të pikave 1, 2,3 të nenit 39 të ligjit “Për Gjendjen Civile”.

(1. Fëmija me prindër të panjohur prezumohet i lindur në vendin ku është gjetur dhe në kohën që përcaktohet me raport mjekësor.

2. Fëmija me prindër të panjohur pajiset me procesverbalin e organeve përkatëse të rendit publik dhe raportin mjekësor të lëshuar nga mjeku i zonës ku është gjetur.



3. Me kërkesë të shërbimit të gjendjes civile ose kryesisht, me miratimin e Kryetarit të Bashkisë/ Njesisë Bashkiakë/Komunës ku është gjetur fëmija, atij i caktohet emri e mbiemri, si dhe emra prindërisht imagjinare, që mund të ndryshojnë me kërkesë të vetë fëmijës, kur bëhet madhore ose më vërtetimin ligjshëm të prindërve.)

Mbas regjistrimit të fëmijës me emra imagjinare të prindërve dhe pajisjes së fëmijës me dokument identifikimi (çertifikatë personale me fotografi), shtetasi



që është kujdesur për regjistrimin e fëmijës, duhet t'i drejtohet gjykatës për marrjen e kujdestarisë së fëmijës, duke shfrytëzuar shërbimet që jepen nga qendrat që ofrojnë ndihmë juridike falas, i ndjekur nga punonjësi social i njësisë vendore.

Në këtë mënyrë, fëmija është i regjistruar dhe ka edhe një kujdestar që ka të njëjtat përgjegjësi me prindin.

Për fëmijët e lindur jashtë shtetit:

Fëmijët që kanë lindur jashtë shtetit dhe për të cilët prindërit disponojnë dokumenta nga materniteti apo nga zyra e gjendjes civile duhet të bëjnë këto veprime:

- Nëse disponohet dokument nga materniteti, duhet të merret një çertifikatë e re e asistencës nga materniteti, e cila mbasi vërtetohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Jashtme e shtetit të huaj, më tej legalizohet në konsullatën shqiptare që mbulon atë zonë. Ky doku-

ment mund të tërhiqet në maternitet vetëm nga nëna. Duke patur çertifikatën e legalizuar të maternitetit, fëmija mund të regjistrohet në konsullatën shqiptare, ose në zyrën përkatëse të gjëndjes civile në Shqipëri.

- Nëse disponohet çertifikatë e gjëndjes civile të fëmijës, e plotësuar në të gjithë përbërësit, kjo çertifikatë vërtetohet në Ministrinë e Brëndshme dhe në Ministrinë e Jashtme të shtetit të huaj dhe më pas legalizohet në konsullatën shqiptare që mbulon atë zonë. Me këtë çertifikatë, fëmija mund të regjistrohet në zyrën përkatëse të gjëndjes civile në Shqipëri.

ELVIRA DERVISHI
Këshilltare e Programit, TLAS

Histori e Vërtetë 1

K.C. kishte lindur një vajzë në një maternitet të Greqisë, por ajo ishte larguar nga materniteti vetëm me një libër shëndeti të fëmijës dhe me asnjë dokument tjetër. Në zyrën e gjëndjes civile ku ajo është e regjistruar, nuk ja pranonin librin e shëndetit si dokument për regjistrimin e fëmijës. Vajza ishte bërë tashmë 7 vjeç dhe vazhdonte të mos ishte e regjistruar në gjëndjen civile. Me ndihmën e Shërbimit Ligjor Falas (TLAS), K.C. arriti ta regjistroje





vajzën në shkollë, duke mundësuar të paktën fillimin e shkollimit të saj, por K.C. e kuptonte se regjistrimi në gjendjen civile ishte shumë i rëndësishëm për të mundësuar identifikimin e vajzës së saj dhe për t'i siguruar asaj të gjitha të drejtat kushtetuese, si çdo shtetas tjetër shqiptar.

TLAS filloi një punë të gjatë dhe të komplikuar për përmbushjen e kërkesave ligjore për regjistrimin e fëmijës së lindur jashtë shtetit. Për këtë ndoqi një sërë hapash:

1. Bëri përkthimin e të dhënave

në Librin e Shëndetit të Fëmijës, nga nxorri emrin me të cilin ishte regjistruar nëna, dhe të dhënat e tjera si data e lindjes së fëmijës, emri i qytetit të lindjes, etj.

2. Realizoi pajisjen e nënës, K.C. me letërnjoftim elektronik.

3. Morri tek noteri një prokurë nga nëna, ku autorizohet avokati i TLAS për tërheqjen e certifikatës së lindjes nga materniteti i Greqisë dhe për ndjekjen e procedurave të legalizimit të kësaj certifikate.

4. Bëri legalizimin e prokurës në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë.

5. Bëri legalizimin e mëtejshëm të prokurës në ambasadën greke në Tiranë.

6. Më tej, procedurat vazhduan në Greqi. Si hap i parë, ishte përkthimi i prokurës nga shqipja në greqisht dhe noterizimi në një zyrë të autorizuar nga shteti grek.

7. Si hap i dytë, ishte kërkesa për tërheqjen e çertifikatës së lindjes së fëmijës, në maternitetin ku K.C. kishte lindur fëmijën. Kjo u realizua nëpërmjet plotësimit të një formulari, ku kërkohejshin të dhënat e personit të autorizuar për tërheqjen e çertifikatës së lindjes, si dhe të dhënat e nënës.

8. Mbas disa ditësh u tërhoq çertifikata e lindjes së fëmijës nga materniteti.

9. Çertifikata më tej, u vërtetua në Ministrinë e Shëndetësisë dhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Greqisë.

10. Hapi përfundimtar ishte legalizimi i çertifikatës në konsullatën shqiptare.

Duke patur në dorë këtë çertifikatë, K.C. mundi të realizojë regjistrimin e vajzës së saj në zyrën e gjëndjes civile. Tashmë vajza ka mundësi të pajiset edhe me librezë shëndetësore dhe mbi të gjitha, më në fund ajo është shtetase shqiptare.

ELVIRA DERVISHI
Këshilltare e Programit, TLAS

Histori e Vërtetë 2

F.K. është tashmë 14 vjeç dhe nuk është edhe i regjistruar në gjëndjen civile. Që në moshën 4 vjeçare, ai jeton në institucionet e kujdesit shtetëror për fëmijët. Nëna e tij po kryen një dënim të gjatë me burgim. Fëmija lindi përpara se nëna e tij të dënohej, në një maternitet të Greqisë, por për shkak se nëna e tij raportoi në maternitet emër dhe mbiemër të remë, dokumentat që pasqyrojnë realisht lindjen e F.K. nuk mund të përdoren. Kur



nëna e F.K. u arrestua, fëmija u dorëzua në Shtëpinë e Foshnjës të K., në bazë të shkresave të lëshuara nga Prefekti i Qarkut dhe Shërbimi Social Shtetëror. Mbasi mbushi moshën e shkollës, F.K. u transferua në Shtëpinë e Fëmijës në T. Gjatw gjithw kwsaj kohe, F.K. nuk ishte i regjistruar nw gjwndjen civile, sepse nuk ishte gjetur mënyra për regjistrimin e tij nga institucionet shtetërore që përkujdeseshin për të. F.K. nuk mund të pajisej me asnjë dokument identiteti.

TLAS morri përsipër që të grumbullonte dokumentacionin e

nevojshëm dhe të realizonte regjistrimin e fëmijës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Gjëndjes Civile, pranë Ministrisë së Brëndshme dhe Drejtorinë e Politikave të Shërbimeve Sociale, pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Mbas kërkimeve në Arkivin e Shtëpisë së Foshnjës të qytetit K. dhe të Shtëpisë së Fëmijës në T., plotësuam dokumentacionin e nevojshëm të dorëzimit të fëmijës në instutucionet e kujdesit shtetëror të fëmijës, gjë që do të shërbente si provë për regjistrimin e F.K. si fëmijë i gjetur, në bazë të legjislacionit në fuqi. Për vetë faktin se kjo procedurë nuk ishte shumë e zakonshme, u nevojit edhe bashkëpunimi me Drejtorinë e Gjëndjes Civile, për të përcaktuar modalitetet e mbajtjes dhe të firmosjes së Aktit të Lindjes. Mbas një numri shumë të madh takimesh, bisedash dhe korespondence me këto institucione, u arrit më në fund të realizohej regjistrimi i fëmijës, me nënë dhe baba të



panjohur. Tashmë F.K. nuk ka asnjë problem për t'u regjistruar në shkollën e mesme dhe për të vazhduar më tej jetën normalisht. Ai i mban kontaktet me nënën e tij dhe familjen e saj dhe pret me padurim që nëna të mbarojë dënimin dhe të bashkohet me të.

Një hap i mëtejshëm i TLAS, do të jetë ndjekja e procedurave për përcaktimin e amësisë së fëmijës. Për shkak të mungesës së plotë të dokumentacionit për vërtetimin e amësisë, kjo gjë do të realizohet me anën e analizës së ADN.

ELVIRA DERVISHI
Këshilltare e Programit, TLAS

Parimi i interesit më të lartë të fëmijës në të drejtën familjare

Parimi i interesit më të lartë të fëmijës është një ndër parimet e përgjithshme të kodit të familjes (neni 2 i Kodit të Familjes, “prindërit..., në vendimet dhe në veprimtarinë e tyre duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës”). Ky parim është një prej parimeve më të rëndësishëm në teorinë e praktiken e çështjeve famil-





jare por dhe më gjërë, është një parim tejet kompleks dhe gjithmone në dinamizem. Për këtë arsye parashikohen nga legjislatori një sërë faktorësh që ndikojnë në zbatimin e këtij parimi, një sërë aktorësh dhe faktorësh që luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e parimit rast pas rasti ku në thelb duhet të mbetet mbrojtja e interesave të fëmijës. Por edhe pse është një parim që zë një vënd thelbësor në legjislacionin në praktikën e zbatimit, qoftë atë gjyqësore apo administrative ndesh veshtirësi të shumta, për shkak që rast pas

rasti mund të jenë objektive e ndodhen brenda sistemit gjyqësor apo infrastrukturor të mbrojtjes së të miturve, por dhe me shkaqe subjektive.

Roli i prindërve është thelbësor në zbatimin e këtij parimi, është detyrë e tyre që në jetën e përbashket ose jo të kenë në qëndër të aktivitetit të tyre interesin e fëmijës. Vlerësohet me mjaft rëndësi që prinderit të kuptojnë dhe të vlerësojnë rëndësinë e përbashkjes së detyrimeve të tyre në favor të fëmijëve sepse ata janë aktorët dhe faktorët kryesorë në jetën e tyre me perkushtimin në përbashkjen e të drejtave të fëmijëve. Në këtë kontekst asnjë autoritet shtetëror apo administrativ nuk mund të zëvendësojë rolin e tyre, i cili në këtë rast do të vepronte si një autoritet që hyn në lojë për të përbashkësuar interesin më të lartë, si domosdoshmëri pas kontradiktave apo pamundësisë së prindërve për të përbashkësuar detyrimet e tyre, në rastet kur ata janë të paaftë për të përcaktuar atë cka është më e mira për fëmijet e tyre.

Në këtë rast jemi pranë situatës ideale të mirëfunksionimit të raportit të familjes dhe të realizimit të qëllimit të saj ku fëmijët jetojnë pranë prindërve biologjike në harmoni të plotë me qëllimin dhe lumturinë që karakterizon të tilla raporte, por jo gjithmonë ndodh kështu. Në përditshmëri ndeshim raste të komplikimit të këtyre raporteve ku kercënohet seriozisht interesi i fëmijëve dhe ku jeta e përbashkët i largohet mjaft normalitetit dhe si pasojë interesat e fëmijëve janë më të brishtat dhe më lehtësisht të prekshmet nga të tilla komplikacione të raporteve ndërmjet tyre.

Për shkak të rëndësisë së këtij grupi të pambrojtur të shoqërisë është legjislatori ai që i garanton mbrojtje nga të tilla situata ekstreme eventuale, të mundëshme në të ardhmen duke krijuar një sërë instrumentash mbrojtës në funksion të këtij misioni, të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës. Garantimi i këtij parimi nga instrumentat ligjore.

Së pari është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë që në nenin 54 të saj sanksionon:

1. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatëzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të vacantë të shtetit.
2. Fëmijët e lindur jashtë martese kanë të drejta të barabarta me fëmijët e lindur nga martesa.
3. Cdo fëmijë ka të drejtë të jete i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për pune e vecanerisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a



zhvillimin e tij normal. Sikurse dhe vihet re në kushtetutë gjejnë vend parime të rëndësishme në funksion të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës, ndonëse jo shprehimisht. Parimi i rëndësishëm për barazinë e fëmijëve të lindur jashtë martese me ata të lindur nga martesa është i garantuar, gjithashtu dhe roli specifik i shtetit për mbrojtje të vëçantë të target grupit për të cilin po flasim, mbrojtje e cila nënkupton dhe përfshin të gjitha organet shtetërore që operojnë me subjekt të miturit duke i dhë-

në parimit një karakter universal. Sipas nenit 122 të Kushtetutës marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara janë pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe si të tilla të detyrueshme për tu zbatuar nga gjykata në veprimtarinë e saj të përditshme. Këtu vlen të përmendet që vendi ynë ka ratifikuar një sërë konventash të rëndësishme të cilat ndikojnë drejtëpërsëdrejti ose terthorazi në realizimin dhe garantimin e këtij parimi. Këtu vlen të përmëndim ratifikimin e konventave të rëndësishme të tilla si: Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, Konventa Evropiane për marrëdhëniet me fëmijët, Konventa e Hagës për "Juridiksionin ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve", Konventa e Hagës "për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vëndit", si dhe një sërë deklarash të rëndësishme që ndikojnë terthorazi lidhur me çështjen sic janë: Dekla-



tata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike Shoqërore e Kulturore, Konventa për të Drejtat Politike dhe Civile, Deklarata "Për eliminimin e të gjitha formave të intolerancës dhe të diskriminimit mbi baze bindjeje dhe besimi" etj.

Në frymën e deklaratave dhe parimeve të tilla është krijuar dhe Kodi i Familjes, një instrument i rëndësishëm në sistemin tonë të brëndshëm për realizimin e këtij parimi (neni 2 i Kodit i sipërcituar ku parashikohet ky parim dhe subjektet kryesore kontribuese). Mirëpo Kodi i Familjes nuk mjaftohet vetëm me shprehjen e këtij parimi si një aksesori i ligjit por vihet re në tërësinë e tij një parashikim për të qënë i zbatueshëm dhe i garantuar në të gjitha aspektet që lidhen me marrëdhëniet personale e pronësore me të miturit dhe për të miturit. Kodi i Familjes tërheq vëmendjen e të gjitha organeve kontribuese në këtë parim të cilat disponojnë apo



mund të disponojnë në të ardhmën në jetën e fëmijëve.

Megjithatë në kontekstin e legjislacionit që e parashikon këtë parim u munduam të paraqesim më kryesorët ndër tyre, ata legjislacione të cilat parashikojnë raportet e drejtëpërdrejta ndërmjet palëve (në këtë rast është fjala për kodin e familjes që rrjedhimisht e për shkak të natyrës e bën detyrimisht pjesë të tij) por duhet të theksojmë që ky është një parim i kudondodhur , pra ai qëndron gjithashtu përtej legjislacionit familjar, në atë penal, në alternativat e dënimit me burgim dhe në ma-



sat edukuese, në zgjidhjen e ceshtjeve të ndryshme me pajtim apo ndermjetësim për zbatimin e këtij parimi etj, pra kudo ka vënd për interesin dhe kujdesin ndaj të miturit.

Gjykata si instrument në realizimin e interesit më të lartë të fëmijës

Gjykata është organi shtetëror që jep drejtësi e zgjidh konfliktet e lindura ndërmjet palëve, është organi tek i cili mishërohet zbtimi i ligjit në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

Personalisht cmoj se në mosmarrëveshjet familjare ku duhet patur në konsideratë interesi

më i lartë i fëmijës në kuptimin e gjërë të tij dhe në atë të ngushtë referuar çështjeve rast pas rast, ky organ duhet të vetëkonsiderohet organ i privilegjuar, pasi vlerëson jo vetëm me racionalitetin strikt që të detyron zbatimi i ligjit por ajo vlerëson dhe konstaton ate cka është më e drejta ne rrafshin njerëzor dhe ndjesor (ndër të rrallat raste mendoj), duke patur në konsiderate subjekte që janë të pambrojtur dhe qe kërkojnë vëmndje të vëçantë dhe tejet komplekse.

Bazuar në këtë vlen të përmendim disa prej problematikave të ndeshura në këtë fushë nga shqyrtimet gjyqësore të rasteve të ndryshme, duke u fokusuar pikerisht këtu, tek problematika, duke synuar gjithmone e më shume realizimin sa me te mirë e të plotë në praktikë të interesit më të lartë të fëmijës.

Nje nga problemet më kryesore dhe të ndjeshme në këtë pjesë të shqyrtimit gjyqësor mbetet çështja e kohës së gjykimit e cila në jo pak raste zgjatet duke krijuar efekte që i largohen qëllimit të interesit më të lartë por

shpesh herë duke sjellë efektin e kundërt të padëshiruar. Në këto raste vonesa përben një rrezik të pakthyeshëm në jetën familjare, të tilla psh janë rastet e dhunës në familje, të përcaktimit të përkohshëm të detyrimit për ushqim, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të mitur, për sigurimin e banimit etj, raste të cilat gjykata mund ti shqyrtojë më mirë apo ti rivlerësojë në vendimin përfundimtar por që për kohën gjatë të cilës bëhet gjykimi kanë nevojë për një zgjidhje të përkohëshme të menjëhershmenë në interes të të miturit për të realizuar qëllimin e interesit me të lartë të tij. Në këtë mënyrë vendimi i gjykatës gjithashtu nuk ngelet thjesht statik, por bëhet elastik dhe me fleksibilitet për ceshtjen dhe realizimin e qëllimit.

Gjykata në vlerësimin e çështjeve të tilla ku pjesë thelbësore të gjykimit janë të miturit duhet të ketë parasysh raportin midis domosdoshmërisë materiale dhe asaj afektive, morale të fëmijës e cila në raste të caktuara është më e rëndësishme



(mund të ketë raste kur mireqënia ekonomike e prindërve nuk shoqërohet me afeksionin për të cilin ka nevojë fëmija apo e anasjellta kur fëmijes së lënë në kujdestari i mungon afeksioni dhe ngrohtësia e prindërve biologjike të tij).

Gjithashtu një rëndësi të vëçantë ka trajtimi i fëmijëve me prindër të njëjtë, të cilët duhet të mos rrinë të ndarë njëri nga tjetri, pasi fëmija kështu rrezikon të humbasë dhe prindërit dhe vëllezërit e motrat.

Lidhur me këtë Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka vënë re shkelje, ku mund të përmendim rastin Kutzner kundër

Gjermanisë ku u konsatantuan shkelje të nenit 8, lidhur me vendosjen e fëmijëve (vëllezër dhe motra) në shtëpi kujdesi të ndryshme dhe kufizimet që ju ishin vendosur prindërve në lidhje me ta. Po këtu gjykata ka vlerësuar që vendosja e fëmijëve në kujdestari është bërë duke u nisur nga kufizimet intelektuale të prindërve dhe jo nga vlerësimi i sjelljes neglizhente dhe abuzimit të tyre ndaj fëmijës.

Prezumohet që është më mirë që fëmijët të jetojnë me prindërit e tyre biologjik me përjashtim kur mirëqenia e fëmijëve kërkon ndryshe, por dhe në jo pak raste të vlerësimit të

këtyre çështjeve janë vënë re shkelje nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, mund të përmendim çështjen P.C dhe S kunder Mbretërisë së Bashkuar ku fëmija ishte vënë në kujdestari menjëherë pas lindjes dhe u konstatuan shkelje lidhur me nenin 8 si dhe me procedurat e vënies në kujdestari apo lejin e birësimit në mënyrë të përshpejtuar. Gjithashtu shkelje lidhur me këtë janë vënë re në çështjen Vanema kunder Hollandës , ku kujdestaria e përkohëshme ishte vendosur pa miratimin e prindërve.

Gjykata gjithashtu në vlerësimin e këtyre çështjeve duhet të ketë parasysh dhe një element që mund të jetë thelbësor për procesin. Në këtë rast flasim për rolin e të miturit në proces dhe prezumimin e të drejtës së të miturit për tu degjuar. Mund të ketë raste kur në zgjidhjen e çështjes në dobi të interesit më të lartë të fëmijës të jetë shumë e nevojshme dëgjimi i opinionit të fëmijës i cili vlerësohet rast pas rasti në lidhje me shumë faktore sic janë moshë, pjekuria



intelektive e tij shëndeti etj. Gjithshtu një rol të rëndësishëm në kontaktin e fëmijës me gjykatën, si një proces me një presion të lartë psikologjik duke marrë parasysh faktorët që përmëndëm më sipër, luan psikologu në atë që quhet “bashkëbisedim klinik” me fëmijën ku shpesh herë vendin e komunikimit verbal e zë dhe veprimi. Por dhe në këtë moment të rëndësishëm të gjykitimit janë vënë re jo pak herë shkelje. Në çështjen Sahin kundër Gjermanisë dhe Sommerfeld kundër Gjermanisë gjyakta konsatatoi shkelje në cënimin e të drejtës së fëmijës për tu dëgjuar dhe në të dytin mungesën e një psikologu në një proces me të miturit i cili të bënte vlerësimin e mendimeve të tij.

Këtu është me rëndësi të përmendim që në praktikën tonë gjyqësore ka mjaft raste ku në praninë e të miturit në procesin gjyqësor fillojnë shkeljet që nga infrastruktura në të cilën zhvillohet gjykimi (këtu është fjala për kushtet aspak komode dhe jo brënda standarteve të ambjen-

teve të gjykitimit ku shpesh herë traumatizojnë dhe nuk japin komfort as për të rriturit).

Një nga rastet e shkeljeve të konsatatuara nga GJEDNJ lidhur me Shqipërinë është rasti Bajrami kundër Shqipërisë ku shteti Shqiptar u ndeshkua për pamundësi për të vënë në ekzekutim vendimin gjyqësor. Në këtë çështje, ati i fëmijës kërkoi të realizonte të drejtën e takimit të vajzës së tij lindur nga martesë me një shtetase shqiptare dhe shteti shqiptar nëpërmjet procedurave të përmbarimit dhe inefikasitetit të ministrisë së drejtësisë u gjënd në shkelje me nenin 8 të KEDNJ.



Lidhur me sistemin tonë gjyqësor vlen te përmëndim dhe disa prej vështirësive të ndeshura në praktikë sic mund të jetë rasti i vështirësisë së përcaktimit të detyrimit për ushqim për shkak të pamunësisë për të vërtetuar të ardhurat e bashkeshortëve dhe kontributin e tyre duke qenë se disa prej tyre punojnë në të zeze dhe të pa siguruar. Gjithshtu problem paraqet dhe emigracioni dhe rastet e gjykim-it ku njëri prej prindërve është emigrant ose të dy, kjo paraqet vështirësi dhe ne rastet kur është e nevojshme përkrahja e fëmijës i cili ndodhet jashtë vëndit. Një tjetër problem mjaft i rëndë-

sishëm, që vjen dhe si një detyrim pozitiv për shtetet nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, që “qeveritë kanë detyrimin pozitiv që të përshtasin legjislacionin penal në mënyrë që të ndëshkohen praktikatat që kanë lidhje me nenin katër dhe i vënë këto në jetë” pra me përfshirjen në legjislacionin penal të veprave penale të denueshme për mënyrat e reja të skllavërimit të fëmijëve. Një rast tipik është ai i Siliadin kundër Francës dhe rasti praqet rëndësi, për faktin se trajton skllavërinë si një problem mjaft të gjerë. Në fund të gjykimit gjykata konstatoi se shfrytëzuesit kishin detyruar te kryhej një pune në disproporcion me mundësitë dhe gjëndjen vunerabël të personit, e cila ishte një vajzë e mitur.



ANISA METALLA
Avokate/këshilltare paraligjore,
TLAS

Histori e Vërtetë 1

Rasti i klientes F.K.

Në zyrën tonë u paraqit klientja me inicialet F.K, për të gjetur zgjidhje lidhur me problemin e saj.

Kjo kliente jetonte sëbashku me vëllain e saj në moshë madhore, i cili vuante nga një prapambetje e rëndë mendore prej shumë vitesh. Klientja F.K interesohej që të merte kujdestarinë ligjore për vëllain e saj, edhe pse prej shumë vitesh ajo ishte kujdestarja e vetme faktike e këtij personi.

Në këto kushte u fillua nga puna për mbledhjen e provave dhe paraqitjen e rastit në gjykatë. Zgjidhja e rasteve të tilla ka një rëndësi të vecantë pasi nuk kemi të bëjmë thjesht me vendosjen e kujdestarisë ndaj një personi, por edhe me heqjen e zotësisë për të vepruar, e cila nënkupton një lloj zhdukjeje civile të personit, pra e bën atë të paaftë për të gëzuar të drejta

dhe për të marrë përsipër detyrime.

Bazuar në përcaktimin e Kodit të Procedurës Civile, në nenin 382 thuhet se “ Heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, bëhet me kërkesë të bashkëshortit, gjinisë së afërt, të prokurorit dhe të personave që kanë interes të ligjshëm për këtë fakt .

Kërkesa i paraqitet gjykatës së vendit ku ka banimin personi që kërkohet t'i hiqet apo kufizohet zotësia për të vepruar”. Pra, ne ishim në kushtet e përcaktuara nga ligji për të ngritur kërkesë-padinë, pasi klientja F.K. legjitimohej si kërkuese.





Edhe procesi i gjykimit të këtyre rasteve ka gjithashtu disa faza dhe bazuar ne nenin 383 te Kodit të procedurës Civile "...gjykata vendos lidhur me kërkesën, pasi të ketë pyetur personin për të cilin kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, persona nga gjinia e afërt e tij, mjekun që e ka kuruar ose pasi të ketë marrë mendimin e mjekëve të tjerë ekspertë, si dhe prova të tjera që do t'i çmojë të nevojshme ...".

Pas sigurimit të të gjitha provave të nevojshme për gjykimin u procedua me hartimin e kërkesë-padisë dhe dërgimin e çështjes në gjykatë.

Deri në këtë fazë rasti nuk paraqiti vështirësi, ndaj u procedua me mjaft efikasitet.

Në fazën e gjykimit, për shkak të parashikimit që bën vetë ligji gjykimi duhet të kalojë në disa faza. Fillimisht u procedua me pyetjen nga ana e trupit gjykues të vetë personit për të cilin ishte vënë në lëvizje gjykata.

Për të pyetur persona të tjerë të afërt ne gjini ishte e vështirë t'ë ishin të pranishëm në këtë gjykim pasi klientja F.K nuk kishte asnjëlloj kontakti me motrat dhe vëllezërit e saj. Për arsye familjare ata kishin krijuar distanca me njëri-tjetrin. Pavarësisht përpjekjeve tona dhe të gjykatës që ata të paraqiteshin në gjykim, kjo nuk u bë e mundur nga ana e tyre. Për këtë arsye ne proceduam me thirrjen në cilësinë e dëshmitares të fqinjes së klientes F.K e cila u paraqiti në gjykim për t'ju përgjigjur pyetjeve tona dhe të gjykatës lidhur me çështjen.

Një problem tjetër që doli gjatë gjykimit ishte thirrja e mjekut i cili ishte marrë në vite me kurimin e personit. Në këtë moment ndeshëm rezistencë nga

ana e mjekut i cili nuk pranonte të vinte në gjykim pavarësisht edhe thirrjeve sistematike të realizuara nga gjykata.

Kjo situatë bëri që gjykimi të shtyhej disa herë dhe gjithashtu e vështirësoi mbrojtjen tonë pasi, në rast të mosparaqitjes së mjekut që ishte marë me mjekimin e personin, gjykata ishte e detyruar të thërriste mjekë të tjerë në cilësinë e ekspertit në cështje dhe si rregull ekspertët duhet të paguhen për aktin e ekspertimit që kryejnë nga personi që vë në lëvizje gjykatën. Në këtë rast do të ishte e pamundur që klientja dhe zyra jonë të përballonte këto shpenzime.

Për këtë arsye stafi ynë u impenjua që rasti të gjente një zgjidhje brenda të gjitha mundësive të shërbimit që ofron Shërbimi Ligjor Falas. Për këtë arsye u gjetën mënyrat për të kontaktuar disa herë me mjekun i cili e kishte kuruar vëllain e klientes F.K.

Pas shumë përpjekjeve ai pranoi që të vinte të dëshmonte në cilësinë e dëshmitarit në gjykim. Pas kësaj faze, gjykimi mori efikasitetin e duhur. Pas mbledhjes

së të gjitha provave dhe dëshmimeve duke i shtuar edhe mendimin e Sektorit të Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Tiranë të cilët ishin thirrur si palë e tretë e interesuar në gjykim, për të dhënë mendimin lidhur me vendosjen e kujdestarisë. Pasi u administruan të gjitha provat, Gjykata më në fund u tërhoq për të dhënë vendimin e saj. Në fund ajo vendoi sipas objektit të kërkesës, duke hequr kështu zotësinë për të vepruar të shtetasit në fjale dhe duke caktuar si kujdestare ligjore klienten tone F.K.

ANISA METALLA

**Avokate/këshilltare paraligjore,
TLAS**



Histori e Vërtetë 2

Rasti i klientes V.T.

Pranë zyrës tonë u paraqit një kliente me initiale R.E, pasi kishte marrë vesh për shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet personave të tjerë ajo u paraqit duke kërkuar njohjen e vendimit civil në shtetin Shqiptar të një gjykate të një shteti të huaj. Vihet re një shtim i numrit të vendimeve të shteteve të huaja në fushën civile sidomos përsa i përket vendimeve që prekin çështje që kanë lidhje me familjen.



U procedua me mbledhjen e dokumentave të nevojshëm sic ishte kryesor vendimi i gjykatës. U mendua që fillimisht të ndiqeshin hapat për verifikimin e të gjithë dokumentacionit që nevojitej sipas kriterëve ligjore. Sipas nenit 396 të Kodit të Procedurës Civile " Kërkesës për t'i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj duhet te plotesojë këto kushte:

Kopja e vendimit që duhet të zbatohet dhe përkthimi i tij në gjuhën shqipe i legalizuar nga noteri. Vërtetim nga gjykata që e ka nxjerrë vendimin se ai ka marrë formë të prerë, si edhe përkthimi e legalizimi noterial i tij. Si kopja e vendimit ashtu edhe vërtetimi se vendimi ka marrë formë të prerë, duhet të jenë vërtetuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë".

U procedua duke legalizuar pranë konsullatës përkatëse vendimin e gjykatës i cili përmbante të gjitha vulat përkatëse të gjykatës që e kishte lëshuar dhe me pas u procedua me

përkthimin e tij në gjuhën shqipe dhe me noterizimin pranë një noteri publik.

Në këto kushte u përpilua kërkesa për njohjen e këtij vendimi në shtetin shqiptar.

Sipas nenit 395 të Kodit të Procedurës Civile “Kërkesa për t’i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj i paraqitet gjykatës së apelit.”

Gjykata e apelit nuk e shqyrton çështjen në themel, por vetëm kontrollon nëse vendimi i paraqitur nuk përmban dispozita që vijnë në kundërshtim me nenin 394.

Kështu në këto kushte vlen të theksohet se neni 394 është mjaft i rëndësishëm për rastin që po trajtojmë pasi ky nen parashikon pengesat ligjore pse nuk mund të zbatohet në shtetin shqiptar një vendim i një shteti të huaj.

Sipas nenit 394 të Kodit të Procedurës Civile: “Vendimit të një gjykate të shtetit të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shqipërisë kur:

a. sipas dispozitave që janë në



fuqi në Republikën e Shqipërisë, mosmarrëveshja nuk mund të jetë në kompetencën e gjykatës të shtetit që ka dhënë vendimin; b. kërkesëpadia dhe letërthirrja për në gjyq nuk i është njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt e në kohë, për t’i dhënë atij mundësi që të mbrohet;

c. midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt e për të njëjtin shkak, është dhënë një vendim tjetër i ndryshëm nga gjykata shqiptare;

ç. është duke u shqyrtuar nga gjykata shqiptare një padi që është ngritur përpara se vendi-

mi i gjykatës së shtetit të huaj të ketë marrë formë të prerë;
d. i është dhënë forma e prerë në kundërshtim me legjislacionin e tij;
dh. nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.

Vendimi i paraqitur nga klintja R.E nuk përmbante asnjë nga këto pengesa ligjore që ta bënin atë të pazbatueshem në shtetin Shqiptar.

U depozitua kërkesa në gjykatë dhe u procedua me hapat e mëtejshëm, gjykata e apelit arriti në përfundimin se vendimi i gjykatës së shtetit të huaj që i përkiste klientes R.E duhej njohur në Shqipëri.

Në këtë mënyrë kjo familje ia arriti qëllimit të saj që pasojat që sillte vendimi i gjykatës së shtetit të huaj të njiheshin edhe në Shqipëri.

ANISA METALLA
Avokate/këshilltare paraligjore,
TLAS

Pensionet e Pleqërisë, Procedura për Aplikimet, Ankimet Administrative dhe Gjykimet

Dhuna në familje është një problem që është shfaqur gjerë në shoqërinë shqiptare në forma nga më të ndryshmet, duke u bërë gjithmonë e më i ndjeshëm në mbarë opinionin.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është akti ligjor më i lartë,



i cili sanksionon parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, si parim përshkues i të gjithë legjislacionit. Gjithashtu, mbrojtja dhe respektimi i dinjitetit, i të drejtave dhe i lirive të njeriut përbëjnë detyrim kushtetues. Megjithatë Kushtetuta parashikon vetëm parimet e përgjithshme, shtyllat kryesore mbi të cilat është ndërtuar legjislacioni në tërësi. Nevoja për një ligj të posaçëm që të parashikojë edhe në imtësi masat dhe mbrojtjen që duhet të ofrojë shteti për parandalimin ose në reduktimin e këtij fenomeni ka qenë gjithnjë evident.



Ndër vite, qeveria shqiptare dhe kuadri legjislativ në Shqipëri, e ka vlerësuar dhunën në familje së bashku me krimet e tjera, duke mos e veçuar dhe trajtuar atë me një kujdes e vëmendje të veçantë. Kodi Penal në Republikën e Shqipërisë nuk ka një dispozitë të veçantë ku të parashikojë specifikisht dhunën në familje si vepër penale, por ky element është konsideruar si rrethanë rënduese në veprat penale që parashikon Kodi Penal.

Dhuna në familje përbën në thelb shkelje të të drejtave themelore të njeriut. Në shoqërinë shqiptare dhuna në familje shfaqet në të gjitha format e saj deri në ekstrem, si vrasja e bashkëshortëve, prindërve apo fëmijëve. Institucionet shqiptare deri në vitin 2006 kishin një zbrazëti legjislacioni, ku mund të mbështetej puna parandaluese apo ndalimi forcërisht i këtyre fenomeneve.



Në vitin 2006, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i cili hyri në fuqi më 1 qershor 2007. i cili përbën një mjet më shumë në dispozicion të institucioneve për të siguruar mbrojtje për viktimat e dhunës në familje. Po ashtu ky ligj përbën edhe një mjet më shumë në dispozicion të viktimave të dhunës në familje.

Ky ligj ka si qëllim parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të për-

shtatshme ligjore si dhe garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.

Sipas Ligjit dhunë në familje do të konsiderohet “Çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër që sjell si pasojë cënimin e integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social dhe ekonomik, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare. Institucionet kryesore që luajnë rol aktiv në zbatimin e këtij ligji dhe në ardhjen në ndihmë të viktimave të dhunës në familje janë Gjykatat të cilat marrin vendime për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe Policia e Shtetit e cila kryen konstatimet dhe hetimet e rasteve dhe po ashtu edhe zbatimin e urdhrave të mbrojtjes të lëshuar nga Gjykata dhe masat në rast mosrespektimi të urdhrit të Gjykatës.

Sipas Ligjit, mënyra e vënies në lëvizje të organeve

përgjegjëse në rast të dhunës në familje kryhet, viktimat duke iu drejtuar me anë të një kërkesë postës së policisë më të afërt (të zonës ku banon ose ndodhet), njësisë përkatëse vendore (komunë, bashki), qendrës shëndetësore të zonës ku banon apo ndodhet ose me kërkesë-padi gjykatës së rrethit të vendbanimit, vendndodhjes së saj ose të dhunuesit/es, për të marrë masat e nevojshme.

Të drejtën e vënies në dijeni të organeve përgjegjëse e ka edhe çdo person i cili konstaton një rast të ushtrimit të dhunës në familje.

Subjektet që kanë të drejtën për të kërkuar urdhrin e mbrojtjes janë:

a) vetë viktimat; b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës; c) policia / prokuroria. Kërkesën për urdhër mbrojtjeje të një të mituri mund ta paraqesin: a) prindi ose kujdestari i të miturit; b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës; c) të afërmit; ç) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e

përhershëm apo të përkohshëm viktimat, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës; d) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/liçencuara nga Ministria e Punës. Në rastin kur kërkesa është paraqitur nga policia/prokuroria, tërheqja e viktimës nga procesi nuk sjell si pasojë mosgjykimin e çështjes së filluar.

Gjykimi zhvillohet sipas rregullave të përgjithshme të gjyimit civil. Provat që duhet t'i paraqiten gjykatës mund të jenë: dëshmi, raporte të policisë, raport



mjekësor, akt-ekspertimi, ekzaminime dhe shpjegime/pohime të palëve, dokumente të tjera të lëshuara nga punonjësit e zyrës së shërbimeve sociale pranë njësive vendore, dokumente të lëshuara nga persona juridikë (OJF), të regjistruara sipas dispozitave në fuqi.

Ligji në nenin 10 të tij parashikon masat mbrojtëse që mund të jepen ndaj dhunës në familje që nga detyrimi i dhunuesit për të evituar çdo lloj kontakti me viktimën si fizik ashtu edhe verbal e deri në detyrimi e dhunuesit që të paguajë qiranë e banesës së përhershme apo të përkohshme

të viktimës, si dhe detyrimin ushqimor për viktimën, fëmijët apo pjesëtarë të tjerë të familjes që ka në ngarkim. Këto masa parashikohen shprehimisht në Urdhrin e Mbrojtjes të lëshuar nga Gjykata.

Gjykata vendos shqyrtimin e kërkesës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes brenda 15 ditëve pas pranimit të kërkesës. Vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, përmban: a) masën e caktuar nga gjykata; b) kohëzgjatjen e masës, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 12 muaj, por me të drejtë shtyrjeje; c) njoftimin se shkelja e urdhrin të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, përbën vepër penale.

Vendimi gjyqësor, që përmban urdhrin e mbrojtjes, përbën titull ekzekutiv pasi të marrë formën e prerë dhe ekzekutohet menjëherë nga përbaruesit gjyqësor, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, komisaritet e policisë dhe njësitë e qeverisjes vendore (bashki, komuna) apo edhe vetë dhunuesi vullnetar-



isht. Gjykata lëshon urdhrin e ekzekutimit në të njëjtën kohë që lëshon dhe urdhrin e mbrojtjes.

Është konstatuar që me hyrjen në fuqi të këtij ligji dhe me aplikimin e tij përmes Gjykatës dhe organeve të Policisë së Shtetit, është pakësuar në krahësim me disa vite më parë numri i rasteve problematike të dhunës në familje.

ADNAN HOXHA
Avokat, TLAS

Histori e Vërtetë 1

Vitet e fundit po vihen re mjaft probleme në lidhje me pensionin e pleqërisë, si për ato raste kur ka aplikime të reja për pension, ashtu edhe në ato raste kur personave iu është caktuar pension dhe e kanë përfituar atë prej disa vitesh. Ne keto raste pas kontrollit të ushtruar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore janë gjetur parregullsi në lidhje me vjetërsinë në punë në regjistrat që disponon DRSSH dhe për rrjedhojë Drejtoria dhe Instituti i





Sigurimeve Shoqërore kanë vendosur ndërprerjen e pensionit. Klientja Sh.Y. kishte përfituar pension për një periudhe rreth 12 vjeçare. Pas ushtrimit të kontrollit nga ana e ISSH ishte vendosur ndërprerja në mënyrë të njëanshme e përfitimit të pagesës së pensionit për arsye se në regjistrat e DRSSH rezultonin parregullsi në lidhje me elementët e marrëdhënieve të punës si data e fillimit, vendi i punës dhe profesioni.

Pasi u paraqit në Zyrën tonë dhe pasi u diskutua çështja nga

këshilltari i projektit u kërkuar dokumentat e nevojshëm që duheshin për të bërë të mundur fillimin e procesit gjyqësor për rivendosjen e pagimit të pensionit. Pasi u mbledhën këto dokumenta u përplua kërkesa për në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt "Shfuqizim i Aktit të mbylljes së pensionit".

Në rastin e paraqitur në klientja Sh.Y. dispononte dokumentin bazë "librezë pune", e cila ishte dublikatë. Në gjykim pati vështirësi lidhur me vlerën provuese të këtij dokumenti, pasi gjykata ishte skeptike lidhur me vlerën provuese të librezës së punës e cila duke qene dublikate dhe jo origjinale nuk ishte shumë bindëse për gjykatën lidhur me shënimet që përmbante. Nga ana e avokatit u argumentua se megjithëse librezë e punës ishte dublikate, ajo gjithsesi përmbush të gjitha kriteret që parashikon ligji për tu konsideruar një dokument zyrtar i vlefshëm për sa kohë nuk goditet për falsitet.

Sipas nenit 253 të Kodit të Pro-

cedurës Civile “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar”.

Po ashtu nga ana e avokatit u kërkua edhe thirrja në gjykim e dëshmitarëve për të vërtetuar dhe për të forcuar bindjen e gjykatës në lidhje me vjetërsinë në punë të klientes. Kjo kërkesë u pranua nga Gjykata dhe u thirrën në gjykim dy dëshmitarë që kishin punuar me klienten të cilët pohuan faktin që kishin punuar në një qendër pune me klienten dhe po ashtu edhe kohëzgjatjen e punës.

Pas disa seancave gjyqësore dhe pas administrimit të të gjitha provave dhe dëshmive të paraqitura në gjykim, gjykata arriti në përfundimin se e gjente të drejtë dhe të bazuar në ligj

kërkesën e bërë nga klientja Sh.Y. duke i dhënë të drejtë për kërkimin e saj duke vërtetuar vjetërsinë e saj në punë dhe duke vendosur për rivendosjen e pensionit dhe pagimin e periudhave të papaguara.

Në këto kushte u arrit në përfundimin e kërkuar nga klientja Sh.Y dhe u vlerësua puna e bërë nga Zyra për Shërbimin Ligjor Falas për zgjidhjen e kësaj çështje.

ADNAN HOXHA **Avokat, TLAS**



Histori e Vërtetë 2

Një fenomen shqetësues i pranishëm është ekzistenca e personave të vdekur të cilët vazhdojnë të jenë të regjistruar në regjistrat e Gjëndjes Civile. Ky problem kondiderohet mjaft i rëndësishëm pasi këta persona të cilët kanë vdekur dhe vazhdojnë të jenë të regjistruar në regjistrat e Gjëndjes Civile kanë krijuar shumë probleme në lidhje me çështje të tjera si problemet e pronësisë, trashëgimisë, listat e zgjedhësve, etj.



Neni 52/3 i ligjit "Për Gjëndjen Civile" parashikon: "Deklarimi i vdekjes bëhet brenda 10 ditëve nga ndodhja ose gjetja e kufomës dhe brenda 60 ditëve, kur vdekja ka ndodhur jashtë shtetit".

Një rast i tillë u paraqit edhe në zyrën tonë, klienti I.B. kërkonte vërtetimin e faktit të vdekjes së djalit të tij në vitin 1992 në një aksident automobilistik. Neni 52/1 i Ligjit "Për Gjëndjen Civile" parashikon: Deklarimi i vdekjes bëhet nga çdo pjesëtar i familjes ose i afërt e, në mungesë të tyre ose për personat pa njeri, nga i ngarkuari i posaçëm i bashkisë ose komunës ku ka banuar ose është gjetur i vdekuri.

Dokumenti bazë që shërben në këto raste është "Akti i Vdekjes" gjë e cila parashikohet shprehimisht nga neni 51/1 i ligjit "Për Gjëndjen Civile": Shtetasi vlerësohet se ka vdekur në fakt, kur vërtetohet me raport mjekësor, në të cilin saktësohen identiteti, fakti, koha, vendi e shkaku i vdekjes së tij.

Por në rastin e paraqitur në Zyrën tonë klienti I.B nuk dispononte

dokumentin bazë “Akt Vdekje”. I vetmi dokument që dispononte ishte një vendim i prokurorit për pushimin e çështjes në ngarkim të drejtuesit të mjetit që kishte shkaktuar aksidentin, në të cilën përshkruheshin rrethanat e ngjarjes, dhe ku përmendej madje edhe emri i viktimës dhe po ashtu edhe fakti i humbjes së jetës. Mirëpo që rasti të ishte më bindës për gjykatën në mënyrë që të vendoste në favor të klientit, u orientua klienti për mundësinë e paraqitjes së dëshmitarëve që kishin dijeni për ngjarjen dhe po ashtu për një vërtetim të lëshuar nga organet e pushtetit vendor që kanë nën administrim varrezat. Mbas diskutimit me avokatët e Zyrës u mendua që çështja të paraqitej në gjykatë me objekt “Vërtetim Fakti i vdekjes” sipas nenit 388 të Kodit të Procedurës Civile.

Pasi u mblodhën dokumentat u përpilua kërkesa për në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe u paraqit kërkesa në gjykatë.

Pas disa seancave gjyqësore gjykata arriti në përfundimin se e gjente të drejtë dhe të bazuar në ligj kërkesën e bërë nga klienti I.B duke i dhënë të drejtë për kërkimin e tij.

Në këto kushte u arrit në përfundimin e kërkuar nga klienti I.B dhe u vlerësua puna e bërë nga Zyra për Shërbimin Ligjor Falas për zgjidhjen e kësaj çështje.

ADNAN HOXHA
Avokat, TLAS



Ankimi kundër vendimeve të komisionit të caktimit të aftësisë për punë (pensionet e invaliditetit)

Ligji për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë parashikon disa kategori pensionesh ndër të cilat edhe pensionet e invaliditetit.

Çfarë është pensioni i invaliditetit dhe kush mund të përfitojë prej tij?

Personi që bëhet i paaftë gjatë

kohës që është i siguruar, merr pension invaliditeti, kur ka plotësuar periudhën minimale të sigurimit dhe për çdo arsye përveç rasteve të aksidentit në punë dhe sëmundjeve profesionale.

Që një individ të përfitojë pension invaliditeti duhet të bëhet i paaftë për çdo lloj veprimtarie ekonomike ose në rastet kur ka dëmtime të forta dhe gjymtime fizike duke përfshirë edhe rastet e verbimit.

Në çdo rast vlerësimi i invaliditetit të një individi përcaktohet nga Komisioni i Caktimit të Aftësisë për Punë. Gjithashtu shkalla e invaliditetit dhe puna që do të kryejë i siguruari, përcaktohet nga komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë për punë (KMCA). Periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa gjysma e diferencës së moshës të personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç.

Në rastet që një individ i plotëson këto kushte, ai mund të përfitojë pension të pjesshëm invaliditeti, bëhet i paaftë të kryejë punën e fundit, por mund të punojë në



kushte të veçanta pune.

Pensionii i invaliditetit të pjesshëm është sa 50 për qind e pensionit të plotë të invaliditetit.

Në rastet që një individ paraqitet në Komisionin e Caktimit të Aftësisë për Punë për të përfituar pension invaliditeti të plotë ose të pjesshëm në rast refuzimi nga ky komision ai ka të drejtë që brenda 30 ditëve të ankohet në Komisionin e Caktimit të Aftësisë për Punë EPROR pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, vendimi i të cilit përsa i përket caktimit të aftësisë për punë është i formës së prerë.

Pikërisht në pjesën që përcakton se vendimi i KMCAE EPROR është i formës së prerë është krijuar një boshllëk ligjor pasi sipas ligjit ky vendim nuk është i ankimueshëm në gjykatë përsa kohë vetë ligji shprehet që është i formës së prerë.

Në praktikën gjyqësore vihet re se një fenomen i tillë, që për të gjitha ankimet që i janë drejtuar gjykatës në lidhje me këtë fakt, gjykata ka mbajtur një qëndrim negativ duke u shprehur se ven-



dimet e Komisionit të Ankimeve janë të formës së prerë dhe nuk i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor. Sipas gjykatave shqiptare ligji që krijoi Komisioni i Caktimit të Aftësisë për Punë tregon shkaqet e paaftësisë për punë, datën e filimit dhe shkallën e paaftësisë, dhe kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në KMCAE EPROR i cili është përfundimtar dhe i pa ankimueshëm.

Ndërkohë që vetë legjislatiioni i brendshëm ka parashikuar ankimim gjyqësor kundër një vendimi administrativ.

Neni 324 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se një palë



“Për Sigurimet Shoqërore” shprehet se: Apelet e zgjedhura në mënyrë të pafavorshme bëhen në gjykatë, nga e cila çështja zgjidhet përfundimisht.

Në lidhje me këtë fakt është shprehur edhe Gjykata e të Drejtave të Njëriut në Strasburg e cila ka theksuar se çdo vendim i KMCAP EPROR duhet ti nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor sipas parashikimeve të legjislacionit të brendshëm.

mund të ngrejë padi në gjykatë me qëllim anulimin ose ndryshimin e një vendimi administrative. Pala duhet të argumentojë që vendimi është i paligjshëm që dhe interesat e saj çënohen drejtpërsëdrejti ose tërthorazi. Gjithashtu nenet 18 dhe 137 të Kodit të Procedurave administrative sanksionojnë parimin e kontrollit gjyqësor të vendimeve administrative me kusht që të jenë përdorur të gjitha mjetet e brendshme të ankimit administrativ.

Gjithashtu neni 86 pika 3 i Ligjit

Gjykata e Strasburgut shprehet se e drejta për gjykatë mbulon çështjet e faktit po ashtu edhe çështjet e ligjit dhe është e nevojshme që vendimet e organeve administrative që nuk përbushin kërkesat ligjore duhet ti nënshtrohen kontrollit pasues të një organi gjyqësor që ka juridiksion të plotë.

Në këto kushte është mëse i qartë fakti se kemi të bëjmë me një vendim i cili parashikon qartë të drejtën për tu ankuar gjyqësisht ndaj një vendimi të Komisionit të Caktimit të Aftësisë për Punë

EPROR pranë ISSH duke mos e trajtuar atë si një vendim përfundimtar të formës së prerë të paankimueshëm.

Aktualisht po punohet për të kryer disa ndryshime ligjore në legjislacionin e brendshëm në lidhje me këtë fakt, për të njëzuar praktikën ligjore duke i dhënë të drejtën individëve që i refuzohet kërkesa për pension invaliditeti nga organet administrative të ankohen në sistemin gjyqësor duke i konsideruar këto vendime si të ankimueshme në gjykatë.

ADRIAN SHEGA
Avokat, TLAS

Histori e Vërtetë 1

Pranë Zyrës tonë u paraqit një kliente me initiale L.N, pasi kishte marrë vesh për shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet personave të tjerë ajo u paraqit duke kërkuar zgjidhjen e martesës me bashkeshortin e saj. Klientja u paraqit dhe nga intervistimi me te u konstatua se kishim te benim me nje individ i cili kishte kryer dy martesa ligjore njera pas tjetres. Kështu klientja L.N ishte martuar ne vitin 1993 me shtetasin K.N



dhe nga kjo martesë kishin lindur një femijë. Në vitin 1995 shtetasi K.L bashkeshorti i saj ishte larguar nga banesa bashkeshortore drejt shtetit Grek për të punuar. Pasi kishte kaluar një periudhë rreth 5 vjetë dhe klientja L.N nuk kishte marrë asnjë njoftim në lidhje me bashkeshortin e saj ajo ishte larguar nga banesa bashkeshortore bashkë me femijen e saj të mitur.

Në vitin 1998 klientja L.N ka lidhur perseri martesë ligjore në një qytet tjetër me shtetasin F.T me të cilin kishte lindur dy femijë. Martesa e dytë ishte lidhur ligjrisht sipas të gjitha procedurave ligjore pavarësisht se klientja

kishte qenë e martuar ligjrisht me parë me shtetasin K.N, fakt i cili kishte ndodhur në rrethana të paqarta pasi legjislacioni shqiptar nuk lejon dy martesë ligjore pa u zgjidhur me parë martesë e parë.

Në këtto kushte klientja L.N kerkonte që të kryente zgjidhjen e martesës me bashkeshortin e saj të parë K.N për të cilin kishte një periudhë pesëmbëdhjetë vjetë që nuk kishte asnjë informacion në lidhje me vendodhjen e tij.

U procedua me mbledhjen e dokumentave të nevojshëm të cilat vërtetonin faktin që klientja L.N kishte lidhur dy martesë duke tërhequr nga Zyrtarë e Gjendjes Civile të dy aktet e martesave si dhe të gjithë certifikatat dhe dokumentat që vërtetonin faktin e largimit të bashkeshorit të saj të parë për më shumë se pesëmbëdhjetë vjetë. U krye një punë e vështirë pasi martesë e parë ishte kryer në një qytet tjetër dhe ishte mjaft e vështirë mbledhja e dokumentave duke marrë parasysh edhe faktin se



klentja ishte shurdh memece. Gjithashtu u mbledhen dokumentat që u konsideruan të nevojshëm për fillimin e procesit gjyqësor.

U mendua që të hartohej një kërkesë duke kërkuar zgjidhjen e martesës për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët për me shume se tre vjet.

Sipas nenit 129 të Kodit të Familjes “Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët kur bashkëshortët jetojnë të ndarë faktikisht që prej 3 vjetësh.

Neni 197 prashikon “Gjykata mund të rrëzojë padinë për zgjidhjen e martesës për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët, kur bashkëshorti tjetër provon se zgjidhja e martesës do të këtë pasoja veçanërisht të rënda morale dhe materiale për fëmijët ose bashkëshortin tjetër”.

Në këtë rast kishim të bënim me një ndërprerje të jetesës së përbashkët për një periudhë shumë të gjatë dhe duke i shtuar faktin se bashkëshorti i parë i klientes



L.N ishte zhdukur pa lënë asnjë njoftim gjithashtu duke shtuar edhe faktin që fëmija i tyre tashmë ishte madhor dhe nuk kishte asnjë pasojë që mund të ndikonte në rritjen e tij.

Neni 41 i Kodit të Familjes parashikon: “Martesa e dytë, e lidhur gjatë vazhdimit të martesës së mëparshme të njërit prej bashkëshortëve, nuk shpallet e pavlefshme, në qoftë se në këtë kohë zgjidhet martesa e mëparshme.”

Në këto kushte iu drejtuam gjykatës për të kërkuar zgjidhjen e martesës së parë për shkak të ndërprerjes së jetesës së për-

bashkët duke marrë parasysh edhe faktin e parashikuar në nenin 41 të Kodit të Familjes që martesë e parë mund të zgjidhet pa u shpallur e pavlefshme martesë e dytë.

U depozitua kërkesë padia në gjykatë dhe u procedua me hapat e mëtejshëm, ku u zhvilluan disa seanca gjyqësore dhe gjykata vendosi zgjidhjen e martesës së parë pasi kjo martesë nuk mund të vazhdonte më pasi e kishte humbur qëllimin e saj dhe nuk sillte pasoja as për bashkëshortin e parë dhe as për fëmijën tashmë madhor.

ADRIAN SHEGA
Avokat, TLAS



Histori e Vërtetë 2

Pranë Zyrës tonë u paraqit një kliente e qytetit të Elbasanit me initiale L.R. Pasi kishte marrë vesh për shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet kontakteve të vazhdueshme të krujuara nga programi i Shërbimit Ligjor Falas nëpërmjet aktiviteteve në komunitet me anë të studentëve që studiojnë për drejtësi, ajo u paraqit duke kërkuar regjistrimin e lindjes së dy fëmijëve të saj. U krijuan disa kontakte me të në qytetin e Elbasanit dhe disa takime në Tiranë pasi klientja vazhdimisht qëndronte në Tiranë për të punuar ndërsa gjëndjen civile e kishte në qytetin e Elbasanit. Nga intervista u konstatua se klientja L.R kishte lindur dy fëmijë nga martesë me shtetasin F.R dhe pavarësisht se lindjet kishin ndodhur jashtë institucioneve të njohura nga ligji ato nuk ishin deklaruar përpara nënpunësit të gjëndjës civile. Gjithashtu nga intervista me klienten L.R u konstatua se një ndër shkaqet që kishin penguar regjistrimin e

fëmijëve të saj ishte pikërisht fakti se klientja L.R e kishte pashaportizimin në qytetin e Elbasanit dhe vetë jetonte e punonte në Tiranë, gjithashtu edhe për shkak të mosnjohjes së ligjit ajo nuk kishte bërë asnjë deklaram të lindjes së fëmijëve përveç faktit që kishte kryer vaksinimin e tyre. Gjithashtu bashkëshorti i saj ndodhej në burg kështu që ajo nuk kishte mundur të kryente e vetme regjistrimin e fëmijëve të saj.

U paraqit çështja në mbledhjen e radhës së Zyrës dhe nga diskutimet u arrit në përfundimin që të përpilohej dhe të ndiqej procedura gjyqësore për regjistrimin e fëmijëve të saj.

U vendos të procedonim me regjistrimin e fëmijëve pranë zyrës së gjëndjes civile të Elbasanit. Duke qenë se klientja L.R kishte probleme pasi nuk mund të shkëputej nga marrëdhëniet e punës u mendua që të përpilohej një prokurë ku ajo të autorizonte një nga avokatët e zyrës që të realizonte të gjitha procedurat e nevojshme për regjistrimin e dy fëmijëve të saj.



Pasi u përpilua prokura, avokatët e zyrës shkuan në qytetin e Elbasanit

U mbledhën të gjitha dokumentat që vërtetonin faktin e lindjes së fëmijëve të klientes L.R në qytetin e Elbasanit dhe në Tiranë njëkohësisht.

Të gjitha këto dokumenta u paraqitën në Gjykatën e Rrethit të Elbasanit që i takonte vendbanimit të kërkueses duke u shoqëruar edhe me një kërkesë nga ana e saj për të bërë të mundur regjistrimin.

Më pas u procedua me ndjekjen e gjyqit për regjistrimin e fëmijëve dhe që u finalizua me vendimin e gjykatës për ti dhënë

të drejtë kërkueses L.R në kërkimin e saj për regjistrimin e dy fëmijëve të saj., Me vendimin e gjykatës bashkë me kërkuesen u paraqitëm në zyrat e gjëndjes civile dhe me dokumentat e gjyqësore arritëm të bëjmë të mundur regjistrimin e fëmijëve në fletën familjare të nënës së tyre.

Kështu këta fëmijë mund të gëzojnë dhe të përfitojnë të gjitha të drejtat që ju njeh ligji. Vlen të theksohet se problemet që kemi hasur gjatë punës me popullsinë Rome janë mjaft të ndërlikuara, por pavarësisht kë-

tyre pengesave Zyra për Shërbimin Ligjor Falas ka bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme që ti vijë në ndihmë jo vetëm komunitetit Rom të Tiranës por edhe atij komuniteti që banon në qytete të tjera të Shqipërisë.

ADRIAN SHEGA
Avokat, TLAS



Seminare me punonjës të zyrave të gjëndjes civile

Shërbimi Ligjor Falas (TLAS) në bashkëpunim të ngushte me Drejtorinë e Gjëndjes Civile në kuadër të zbatimit të projektit “Rritja e Aksesit në Drejtësi të komuniteteve vulnerabël” të mbështetur nga UNICEF, organizoi dymbëdhjete seminare trajnuese në nëntë rrethe të Republikës së Shqipërisë.

Synimi kryesor i këtyre seminareve ishte njohja dhe trajnimi i punonjësve të gjëndjes civile të këtyre rretheve me përmiresimet e bera ligjit të gjëndjes civile si dhe sqarimin e problematikave të hasura nga këta të fundit gjatë punës së tyre.

Përzgjedhja e rretheve nuk ishte rastësore, për përcaktimin e rretheve u mbajtën parasysh disa kriterë si: numri i popullësisë që kishin, largësia nga qendrat e qyteteve gjë që sjell dhe një mungesë më të theksuar të njohjes së ndryshimeve ligjore si dhe numri i rasteve problematike të



shfaqura dhe që janë ngushtësisht të lidhura me ndryshimet e bëra ligjit të gjëndjes civile. Dhe kryesisht rrethet në të cilën u zhvilluan seminarët ishin: Sarandë/Delvine, Kukës /Has, Lezhë/Kurbin, Tropojë/Pukë, Peshkopi, Fier/Mallakastër, Kavajë/Rrogozhin, Elbasan/Peqin, Krujë dhe tre seminare u zhvilluan në qytetin e Tiranës me punonjës të gjëndjes civile të komunave të këtij rrethi.

Nga cdo zyrë e gjëndjes civile u përzgjodhën nga dy përfaqësues që do të trajnoheshin dhe që këta do jenë dhe transmetues të informacionit të

marr dhe tek kolegët tyre që nuk ishin pjesëmarrës.

Që trajnimi të ishte efektiv, informacioni që referohej nga trajnuesit u shoqërua dhe me shpërndarjen e materialeve shpjeguese e broshurave që paraqisnin në mënyrë të përmbledhur informacionin si dhe e bënë më të kuptueshëm duke e konkretizuar në raste tipike.

Trajnerët ishin avokatë të zyrës Shërbimi Ligjor Falas që përveç janë avokatë me vite eksperience në këtë fushë dhe të kualifikuar, kanë qënë dhë në gru-

pin iniciues për përmirësimet që i janë bërë ligjit të gjëndjes civile, e normalisht janë më në brendësi të logjikës juridike që është ndjekur gjatë hartimit të ndryshimeve por dhe të vakumeve ligjore që të plotësojnë këto përmisime.

Trajnimi u asistua dhe nga Drejtoria e Gjendjes Civile me dy ekspertët e saj.

Trajnimi niste me relatimet nga trajnuesit që shpjegoni ligjin dhe ku konsistojnë ndryshimet dhe më pas ndiqej me rastet e përzgjedhura nga zyra si sh-



embull për konkretizim dhe më pas me rastet e sjella nga vetë punonjësit dhe që ishin raste të ndërlukuara që ishte e nevojshme asistenca e avokatëve.

Të dymbëdhjetë trajnimet ishin të sukseshme pasi jo vetëm që pati pjesëmarrje por punonjësit treguan interes dhe u aktivizuan maksimalisht duke dhënë zgjidhjet e duhura gjë që tregon që trajnimi ishte frytdhënës dhe që u absorbua shumë mirë nga pjesëmarrësit.

Numri i pjesëmarrësve që kanë përfituar nga keto trajnime ka qënë afërsisht 200 persona. Më poshtë është dhe tabela përmbledhëse me datat, vendet dhe numrin e pjesëmarrësve në të dymbëdhjetë trajnimet. Besoj që në të ardhmen trajnime të tilla të sukseshme dhe bashkëpunimi i ngushtë me Drejtorinë e Gjendjes Civile do të vazhdojnë.

RINA PERO
As. Avokate, TLAS



Nr.	Data	Vendi	Nr, Pjesemarrësve	Staf
1	26.03.2011	Elbasan	23	6
2	02.04.2011	Lezhë	20	5
3	09.04.2011	Kavajë	18	6
4	16.04.2011	Fier	20	6
5	21.05.2011	Peshkopi	26	5
6	27.05.2011	Kukës	15	5
7	28.05.2011	Tropojë	9	5
8	4.06.2011	Krujë	13	5
9	11.06.2011	Sarandë	17	5
10	16.06.2011	Tiranë	21	5
11	17.06.2011	Tiranë	20	5
12	18.06.2011	Tiranë	22	5

FOTO NGA SEMINARET NE RRETHE



Foto nga
TIRANA



Foto nga
TIRANA



Foto nga
TIRANA



Foto nga
KAVAJA



Foto nga
FIERI



Foto nga
SARANDA

FOTO NGA SEMINARET NE RRETHE



Foto nga
ELBASANI



Foto nga
KRUJA



Foto nga
LEZHA



Foto nga
PESHKOPIA



Foto nga
**KUKES -
TROPOJE**



Foto nga
**KUKES -
TROPOJE**

SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË

Nr. 2 / 2011

TLAS

